

VENDIM
Nr.359, datë 4.5.2011

**PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE
NË FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç” të nenit 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar dhe të paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale, të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore, të zëna, sipas listës dhe planvendosjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi, përkatësisht:

a) në qarkun Tiranë, 492 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 90 844,41 (nëntëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet e katër presje dyzet e një) m²;

b) në qarkun Durrës, 307 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 97 957, 80 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë presje tetëdhjetë) m²;

c) në qarkun Shkodër, 164 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 18 829, 11 (tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet e nëntë presje njëmbëdhjetë) m²;

ç) në qarkun Lezhë, 143 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 51 813, 64 (pesëdhjetë e një mijë e tetëqind e trembëdhjetë presje gjashtëdhjetë e katër) m²;

d) në qarkun Berat, 102 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 16 276, 83 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë presje tetëdhjetë e tre) m²;

dh) në qarkun Fier, 177 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 47 231, 40 (dyzet e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e një presje dyzet) m²;

e) në qarkun Korçë, 30 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 818, 36 (tre mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë presje tridhjetë e gjashtë) m²;

ë) në qarkun Elbasan, 283 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 78 973, 50 (shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre presje pesëdhjetë) m²;

f) në qarkun Vlorë, 276 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 81 728, 90 (tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind e njëzet e tetë presje nëntëdhjetë) m²;

g) në qarkun Kukës, 50 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 5 226, 95 (pesë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë presje nëntëdhjetë e pesë) m²;

gj) në qarkun Dibër, 19 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4 166,70 (katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë) m²;

h) në qarkun Gjirokastrë, 2 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 196

(njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m².

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore të objekteve informale, nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha